REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
KUVENDI KOMUNAL/ASSAMBLY OF MUNICIPALITY/SKUPŠTINA OPŠINA
SKENDERAJ
Nr. No. 01-110/01-0025382/22
Data Data 06.06.2022

Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

Komuna Skenderaj
Opština Skenderaj
Municipality of Skenderaj

RREGULLORE
PËR TAKSA, TARIFA, NGARKESA DHE GJOBA
KOMUNA SKENDERAJ

Skenderaj, 2022

Në bazë të nenit 11 dhe 12, paragrafi 1 dhe paragrafi 2, shkronja c), të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, Nr-03/L-040, ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", Nr. 28/2008), nenit 2 Paragrafi 3 neni 8, neni 13, 15 dhe 16 të Ligjit për Financat e Pushtetit Lokal, Nr-03/L-049, ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", Nr. 27/2008), nenit 20 dhe 61 të Statutit të Komunës së Skenderajt Nr. 01-110-385 të datës 03.12.2008, Kuvendi i Komunës së Skenderajt me datën 31.03.2022, miratoi rregulloren për taksa, tarifa, ngarkesa dhe gjoba, e pas vlerësimit të ligjshmërisë, sipas kërkesës së MAPL-së Nr.43-315/5 të datës 27.04.2022, dhe kërkesës së MBPZHR nr.1499/3 të datës 29.04.2022, Kuvendi i Komunës së Skenderajt në mbledhjen e mbajtur me datën 31.05.2022 miratoi këtë:

RREGULLORE
PËR TAKSA, TARIFA, NGARKESA DHE GJOBA KOMUNA SKENDERAJ

DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1
Qëllimi

Me këtë Rregullore caktohet lartësia e tarifave dhe ngarkesave për shërbime nga veprimtaritë komunale, që do t'i paguajnë personat fizikë dhe juridikë në emër të: shërbimeve komunale, lëshimit të dokumenteve publike, përpilimit të shkresave dhe ofrimit të shërbimeve profesionale sipas kërkesës së palëve, apo sipas detyrës zyrtare, lejeve të punës për ushtrimin e veprimtarisë tregtare, lejeve për shërbime profesionale, pronësisë së automjeteve motorike, përdorimit apo shfrytëzimit të pronës komunale, ngarkesave për ndërtimin dhe rrënimin e objekteve, shfrytëzimin e burimeve natyrore, të hyrave nga qiradhënia dhe gjobat komunale - gjobat nga trafiku dhe gjobat për shkeljen e rregulloreve komunale.

LARTËSIA E TARIFAVE DHE NGARKESAVE

Neni 2

Lartësia e tarifave dhe ngarkesave që do të paguajnë personat fizikë e juridikë, në emër të shërbimeve apo veprimtarive komunale sipas drejtorive, në pajtim me këtë Rregullore, do të jenë, si vijon:

Neni 3
DREJTORIA PËR ADMINISTRATË

Tarifat për lëshimin e vërtetimeve dhe dokumenteve zyrtare

Sektori i përgjithshëm	Nr.	**EMËRTIMI** (i ngarkesave, kompensimeve dhe taksave në shërbime)	Euro(€)
	1	Vërtetime dhe dokumente të ndryshme	1.00
	2	Vërtetimi i fotokopjes nga identiteti i origjinalit	1.00
	3	Kërkesë për referencë	2.00

	4	Certifikatë të lindjes- ekstrakt të lindjes	1.00
Certifikatat – Sektori i gjendjes civile	5	Certifikatë të martesës	1.00
	6	Certifikatë të vdekjes	1.00
	7	Certifikatë për gjendjen martesore	2.00
	8	Certifikatë e shtetësisë	2.00
	9	Certifikatë e vendbanimit	1.00
	10	Formular për ç' lajmërimin e vendbanimit	2.00
	11	Vërtetim nga arkiva	1.00
	12	Për korrigjimin e emrit personal Nëse ka qenë gabim i Komunës të jetë falas	5.00 0.00
	13	Për ceremoninë e lidhjes se martesës–ne mes të dy shtetasve te R. Kosovës	5.00
	14	Kurorëzimi jashtë objektit të Komunës, brenda territorit të Komunës, gjatë orarit të punës- ne mes të dy shtetasve te R. Kosovës	50.00
	15	Për lidhje të martesës, kur njeri bashkëshort është shtetas i huaj, brenda orarit të punës, në objektin e komunës	25.00
	16	Deklarata për rikthim të mbiemrit pas shkurorëzimit	2.00
	17	Për lidhje te martesës me shtetas te huaj, jashtë orarit të punës dhe jashtë selisë së komunës	70.00
	18	Dëshmi vdekje(regjistrim i trashëgimisë)	2.00
	19	Për deklaratë te bashkësisë familjare .	1.00
	20	Regjistrime të rregullta të lindjes dhe vdekjes	2.00
	21	Regjistrime pas afatit 30 ditësh në RGJC për të lindur	25.00
	22	Regjistrimet pas afatit 30 ditësh në RGJC të vdekjes	50.00
	23	Ndërrimi i emrit personal	20.00
	24	Anulimi i regjistrimit të dyfishtë	1.00
	25	Regjistrimin e lindjes, vdekjës dhe martesës nga diaspora brenda afatit - legalizimi	2.00
	26	Regjistrimin e lindjes nga diaspora pas afatit 30 ditësh	25.00
	27	Regjistrimin e vdekjes nga diaspora pas afatit 60 ditësh	50.00
	28	Kërkesa për humbje dhe fitim të shtetësisë	2.00
	29	**Personat e liruar/a nga pagesat në shërbimet e Drejtorisë për Administratë duhet të sjellin dëshmi dokumentin për lirim- kopje**	
	29.1	Rastet sociale (dëshmia nga Qendra për Punë Sociale – vlefshmëria e kartelës)	0.00
	29.2	Familjarët e Dëshmorëve të luftës prindërit, bashkëshortet, dhe fëmijët deri ne moshën 18 vjeçare, si dhe studentet anëtar të familjeve të kësaj kategorie qe studiojn deri ne moshën 26 vjeqare.	0.00
	29.3	Invalidët e luftës të UÇK-së, duke i përfshirë edhe familjarët, si prindërit, bashkëshortet, si dhe studentet anëtar te familjeve të kësaj kategorie qe studiojn deri ne moshën 26 vjeqare	0.00

	29.4	Familjaret e viktimave të luftës	0.00
	29.5	Personat më aftësi të kufizuar	0.00
	29.6	Veteranët e luftës së UÇK-së, duke i përfshirë edhe familjarët, prindërit, bashkëshortet, dhe fëmijët deri ne moshën 18 vjeçare, si dhe studentet anëtar të familjeve të kesaj kategorie qe studiojn deri ne moshen 26 vjeqare.	0.00

Neni 4

DREJTORIA PËR ZHVILLIM EKONOMIK, NDERMARRËSI, INOVACION DHE TURIZËM

Ngarkesat vjetore për ushtrimin e veprimtarisë afariste biznesore në territorin e Komunës së Skenderajt

Veprimtaria	Tarifa
Postat, shërbimet e telefonisë mobile	1500,00
Bankat dhe kompanitë e sigurimeve	1500,00
Njësite bankare	500,00
Njësite e kompanive të sigurimeve	250,00
Kompania Kosovare për Distribuim dhe Furnizim me Energji Elektrike KESKO/KEDS	2000,00
Njësite tjera mikrofinanciare	250,00
Përfaqësitë e kompanive të jashtme financiare	250,00
Veprimtaritë tjera financiare	250,00
Qendrat tregtare	500,00
Gurëthyesit	400.00
Tregtia me pakicë e naftës dhe derivateve te sajë/biznesi bazë	500.00
Tregtia me pakicë e naftës dhe derivateve te sajë/njësia	150.00
Tregtia me pakice e pjesëve te automjeteve	200.00
Tregtia me pakicë e mjeteve farmaceutike (barërave, medikamenteve)	300.00
Tregtia me pakicë e stolive (argjendarët)	500.00
Restorantet me hapësirë për ahengje- dasma e tjera	500.00
Motelet	400.00
Veprimtaritë tjera profesionale (Laboratorët etj)	100.00
Shërbimet e ordinancave private	200.00
Çerdhet private	150.00
Veprimtaritë tjera të natyrës biznesore (jo prodhuese) të pa përfshira në këtë tabelë.	50.00

4. 1. Ngarkesat me taksë komunale në biznes

Obligues për taksën në biznes janë të gjitha bizneset dhe organizatat e ndryshme të renditura në tabelën më lartë, që ushtrojnë veprimtarinë bazë, kanë njësi punuese, dhe janë të shtrira brenda territorit të Komunës se Skenderajt.

4.2. Perioda e ngarkesës dhe afati i pagesës:

Ngarkesa bëhet për një vit kalendarik, me faturë. Faturat do përgatitën deri me 30 prill të çdo viti, ndërsa shpërndarja deri të biznesi do të behët deri me 31 majë të vitit të ngarkesës, kurse afati i pagesës do te jenë deri me 30 qershor.

4.3. Të drejtat dhe obligimet e taksë-paguesit:

4.3.1. Taksapaguesi në rast së do të ndërpres ushtrimin e veprimtarisë afariste, përkohësisht apo përherë është i obliguar që menjëherë të informoj me shkrim, (kërkesë) Drejtoria për zhvillim Ekonomik, Ndërmarrësi, Inovacion dhe Turizëm, në të kundërtën do te mbetet i ngarkuar deri ne parashtrimin e kërkesës. Taksapaguesi, paraprakisht, obligohet të kryej të gjitha obligimet e pa kryera para se t'i mbyllet veprimtaria e biznesit me kërkesën e tij.

4.3.2, Drejtoria kompetente përmes zyrtarëve përkatës, pas verifikimit të gjendjes, në afatin ligjor, do të shqyrtoj ankesën - kërkesën dhe do të kthej me shkrim përgjigjen.

4.4. Lehtësirat e parapara për biznese

4.4.1. Me qëllim të stimulimit të zhvillimit të bizneseve vendase dhe tërheqjes se investitorëve te jashtëm Komuna i liron të gjitha llojet e bizneseve prodhuese nga ngarkesat vjetore të taksës.

Neni 5
DREJTORIA PËR BUXHET DHE FINANCA

Taksa komunale për pronësi të automjeteve

5.1. Banorët dhe subjektet ekonomike, etj. obligohen të paguajnë taksë mbi pronësinë e automjetit të vet brenda territorit te Komunës se Skenderajt.

5.2. Taksa për pronësinë e automjetit paguhet paraprakisht në komunë, me rastin e regjistrimit pranë autoritetit përkatës te Kosovës, duke prezantuar dokumentet e pronësisë dhe llojit të automjetit, (librezën e automjetit).

5.3. Taksa mbi pronësinë e automjetit paguhet çdo vit, me rastin e regjistrimit, dhe atë në bazë të peshës neto, sipas dokumentit të vlefshëm që prezanton pronari.

5.4. Këto taksa paguhen sipas kategorizimit të automjetit:

a) Automjetet me peshë deri 3 t ..... 10,00 €
b) Automjetet me peshë mbi 3 t ..... 20,00 €

5.5. Taksa per pronësinë e Automjeteve zyrtare të Komunës, Shëndetësisë, Arsimit, Shërbimeve Emergjente dhe të Zjarrfikësve nuk zbatohen.

5.6. Për të gjitha mjetet që merren me zhvillimin e veprimtarisë bujqësore dhe është pronar bujku individual, përveç subjektit ekonomik, nuk ngarkohen me taksë komunale për biznes.

5.7. Nga taksa për automjete lirohen Invalidët e luftës, dhe personat me aftësi te kufizuara. Lirimi bëhet ne bazë te prezantimit të dëshmisë (dokumenti behet fotokopje dhe i bashkëngjitet kërkesës), dhe ne këto raste zyrtari për pagesa lëshon fletë-pagesa me vlerën zero (0) duke ia bashkangjitur dëshminë.

Neni 6

Taksat për shërbimet tjera në Drejtorinë për Buxhet dhe Financa

6.1. Certifikatat e gjëndjës ekonomike 1.00 €

6.2. Vërtetime të ndryshme 1.00 €

6.3. Nga taksa për shërbimet e mësipërme (pika 6.1 dhe 6.2) lirohen studentët (si dëshmi merret dokumenti identifikues, kartela e studentit, fotokopje).

Neni 7
Parashtrimi i ankesës

7.1. Obliguesi, i pakënaqur me llojin dhe lartësinë e caktuar të tarifës dhe të ngarkesës sipas kësaj rregulloreje, përkatësisht me aktin e organit të komunës me të cilin është përcaktuar pagesa e obligimit, mund të parashtrojë ankesë në afat prej 30 ditësh nga dita e njoftimit për obligim (pranimit të fatures).

7.2. Ankesa i parashtrohet – Drejtorisë përkatëse, e cila e ka përcaktuar shumën e obligimit për pagesë në emër të tarifës - ngarkesës.

7.3. Ankesa nuk e shtynë ekzekutimin e Vendimit.

7.4. Masat ndeshkuese për mos kryerje të obligimeve:

7.4.1. Nëse subjektet e caktuara nuk kryejnë detyrimet brenda afateve të caktuara, do të ndërmerren masat e nevojshme ligjore sipas legjislacionit përkatës në fuqi.

Neni 8
DREJTORIA PËR BUJQËSI, PYLLTARI DHE ZHVILLIM RURAL

1. Tarifat në sferën e bujqësisë, blegtorisë dhe pylltarisë

NDËRRIMI I DESTINIMIT TË TOKËS BUJQËSORE		
Nr.	Emërtimi i kategorisë së tokës	Vlera
1.	Kategoria e tokës\ klasë e 1-4	1.00 € \ m^2
2.	Kategoria e tokës \ klasë e 5-6	0.75 € \ m^2
3.	Kategoria e tokës \ klasë e 7-8	0.50 € \m^2
DHËNJA E PËLQIMEVE, VËRTETIMEVE NGA LËMI I BUJQËSISË DHE PASURIVE		

TJERA BUJQËSORE		
Nr.	Kategorizimi i dokumentit	Vlera
1.	Dru zjarri për m^3, në shumën prej Dru zjarri mbi 7 m^3, në shumën prej Dru teknik për m^3, në shumën prej	1.50 € 2.00 € 3.00 €
2.	Vërtetim për bujqësi- për rregullimin e vizave turistike	5. 00 €
3.	Trajtimi i qenve endacak dhe shtëpiak me kërkesë të pronarit	35. 00 €
4.	Çertifikatë për regjistrimin e fermerit	1.00 €

2. Taksa për kullotjen e bagëtisë

2.Lartësia e taksës për shfrytëzimin e kullotave caktohet në bazë të llojit dhe kategorisë së bagëtisë. Taksa për shfrytëzimin e kullotave publike është 1.20 EUR për njësi blegtorale (NB). Tabela vijuese paraqet njësitë blegtorale sipas llojit të bagëtisë dhe lartësinë e taksës për kokë të bagëtisë:

Lloji i bagëtisë	NB / kokë	EUR / kokë
Gjedhët mbi një vjet	1	1.20
Viçat	0.45	0,54
Delet	0.18	0.22
Qengjat	0.1	0,12
Kuajtë dhe gomarët	1	1.20
Dosat	0.5	0.60
Derrat	0,3	0.36
Rosat	0.014	0,02

Neni 9
DREJTORIA PËR URBANIZËM DHE MBROJTJE TË AMBIENTIT

9.1 Tarifat (ngarkesat) e përgjithshme nga kjo Drejtori bazohen në nenin 22 të Ligjit Nr. 04/L-110 për Ndërtim dhe në Udhëzimin Administrativ Nr.02/2018 për Taksat Administrative, ndërsa tarifat për leje mjedisore lëshohen në përputhje Ligjin Nr.03/L—025 për Mbrojtjen e Mjedisit dhe me nenin 15 të Udhëzimit Administrativ nr.01/2017 për Dhënien e Lejes Mjedisore Komunale.

Nr.	EMËRTIMI I KËRKESAVE (i ngarkesave, kompensimeve dhe taksave në shërbime)	Euro(€)
1.	Vendim për leje rrënimi të objekteve	5.00
2.	Vendim për leje ndërtimi për të gjitha llojet e investimeve të specifikuara me ligjin e ndërtimit.	10.00

3.	Vendim për leje përdorimi	10.00
4.	Lëshimi i kopjeve të aktvendimeve	10.00
5.	Vendimi për vazhdimin e lejes së ndërtimit	10.00
6.	Pëlqim për vendosjen e objekteve të përkohshme	10.00
7.	Pëlqim për shfrytëzim të hapësirave publike	10.00
8.	Pëlqimet mjedisore	10.00
9.	Inspektim në terren me kërkesë të palës	10.00
10.	Lejet mjedisore Komunale	0.2% e vlerës investive të projektit

9.2 Tabela për taksa për leje ndërtimi (Komuna ka HZK të miratuar 2020-2028)

- **LNA -** Taksa administrative për leje ndërtimi
- **LNI -** Taksa e infrastrukturës – densitetit

	Sipas PZHK dhe HZK			
Nr.	Llojet e ndërtimeve	Njësia	LNA	LNI
1	Për ndërtimin e objekteve për Kategorinë I	m^2	1.30	174.42
2	Për ndërtimin e objekteve për Kategorinë II	m^2	3.41	174.42
3	Për rrënimin e objekteve	m^2	0.50	
4	Për ndërtimin e depove për deponim dhe shitje të mallrave	m^2	3.41	-
5	Për fusha të mbuluara sportive, pishinat	m^2	3.41	-
6	Për fusha të pambuluara sportive, platotë e pompave, tribuna	m^2	1.5	-
7	Për ndërtimin e shtallave të kafshëve dhe shpezëve	m^2	1.5	-
8	Për ndërtimin e depove për ruajtjen e pemëve dhe perimeve	m^2	1.5	-
9	Për vendosjen e infrast.nëntokësore dhe mbitokësore (përjashtim ujësjellësi dhe kanalizimi)	m^2	0.5	-
10	Për vendosjen e billbordeve dhe reklamave (pasi të caktohet lokacioni nga DSHP)	m^2	50	-
11	Shëndrrimi i lokalit banues në lokal afarist	m^2	3.41	
12	Ndërtimi i objekteve me karakter të përkohshëm	m^2	3.41	

Për bizneset të cilat do të hapen në kuadër të Komunës më veprimtari prodhuese dhe punësojnë mbi 10 punëtor të lirohen nga taksat për leje ndërtimore.

9.3 Nëse paraqet investitori kërkesa për rrenim për objektin i cili ka poseduar leje aty i zbriten pagesa e taksës për atë sipërfaqe të lejës paraprake të ndërtimit.

Neni 10
DREJTORIA PËR GJEODEZI KADASTËR DHE PRONËSI

Tarifa e shërbimeve kadastrale komunale të përcaktohen me UA Nr. 09/2020 dhe UA Nr. 05/2021 Për ndryshimin dhe plotësimin e UA Nr. 09/2020.
Tarifat e rekomanduara nga Agjencia Kadastrale e Kosovës do të jenë të aplikueshme.

10.1 Dhënia e dëshmive nga baza e të dhënave kadastrale tekstuale apo grafike sipas kërkesës së palës nga ZKK:

Nr.	Produkti	Çmimi / €
1	Dhënia e vërtetimeve të ndryshme	3.00
2	Certifikate e pronës deri ne 10 faqe	4.00
3	Certifikate e pronës mbi 10 faqe	20.00
4	Kopja e planit për një parcele	4.00
5	Kopja e hartës kadastrale A0. Letër e thjeshtë, horizontal (1:500,1000, 1:2500, 1: 5000)	30.00
6	Historiati për një parcelë	20.00

10.1.1 Punët e zyrës sipas kërkesës se palëve

Nr.	Produkti	Çmimi / €
1	Tarifa për regjistrimin e njësisë kadastrale të krijuar nga ndarja apo bashkimi / për njësi	20.00

Lirohen nga pagesa e tarifës për vërtetime dhe certifikatë të pronësisë rastet sociale. Për t'u liruar nga pagesa nevojitet dëshmia (kartoni) nga qendra për punë sociale. Lirohen edhe rastet e tjera te rregulluara me ligj.

10.2 TARIFAT E SHËRBIMEVE PËR REGJISTRIMIN E TË DREJTAVE TË PRONËS SË PALUAJTSHME TË PËRCAKTUARA ME UDHËZIMIN ADMINISTRATIV.(MMPH) Nr. 09/2020

Regjistrimi i pronësisë, shfrytëzimit, në bazë të transaksioneve (shitblerjes)

10.2.1 Regjistrimi i pronësisë, shfrytëzimit sipas transaksioneve do të bëhet sipas vlerave të transaksioneve të kryera për pronën e paluajtshme.

Nr.	Produkti	Çmimi / €
1	Për vlerën e transaksionit deri në 10.000 €	30.00
2	Për vlerën e transaksionit prej 10.001 € e deri në 50.000 €	50.00
3	Për vlerën e transaksionit prej 50.001 € e deri në 100.000 €	70.00
4	Për vlerën e transaksionit prej 100.001 € e deri në 200.000 €	90.00
5	Për vlerën e transaksionit prej 200.001 € e deri në 500.000 €	120.00
6	Për vlerën e transaksionit prej 500.001 € e deri në 100.000.00 €	240.00
7	Mbi vlerën mbi 1.000.000	500.00

10.2.2 Regjistrimi i pronësisë , shfrytëzimit në bazë të dokumentit mbi dhuratën

Nr.	Produkti	Çmimi / €
1	Nëse në dokumentin (kontratën) mbi dhurimin e pronës së paluajtshme e qe dhuratëmarrës është anëtari i familjes apo pasardhësi i dhuratëdhënësit	30.00
2	Nëse në dokumentin (kontratën) mbi dhurimin e pronës së paluajtshme e qe dhuratëmarrës nuk janë anëtaret e familjes apo pasardhësit e dhuratëdhënësit dhe nuk është e caktuar vlera e pronës	80.00
3	Regjistrimi i pronësisë, shfrytëzimit në bazë të dokumentit të organeve administrative dhe gjyqësore mbi njohjen e të drejtës së pronësisë	30.00
4	Regjistrimi i të drejtave mbi pronën e paluajtshme e cila fitohet në bazë të vendimit të organit administrativ apo gjyqësor	30.00
5	Regjistrimi i pronësisë, shfrytëzimit në bazë të pjesëtimit (ndarjes) të pronës në bashkëpronësi dhe pronësisë së përbashkët	20.00
6	Regjistrimi i pronësisë, shfrytëzimit të bashkëpronësisë për një akt juridik me të cilin është vendosur bashkëpronësia	20.00
7	Regjistrimi i pronësisë, shfrytëzimit në bazë të pjesëtimit (ndarjes) fizike të pronës nga bashkëpronësia, pagesa behët nga secili bashkëpronar që behët pronarë individual nga pjesëtimi fizik i pronës	30.00
8	Regjistrimi i pronësisë në pronësi te përbashkët ne emër te bashkëshortëve është i liruar nga taksat, me udhëzim administrativ	00.00
9	Regjistrimi i pronësisë së përbashkët të ndërtesave kolektive në bashkëpronësi janë te liruara	00.00
10	Regjistrimi i pronësisë , shfrytëzimit në bazë të Trashëgimisë, për çdo trashëgimtar	10.00
11	Regjistrimi i pronësisë, shfrytëzimit në bazë të shkëputjes së bashkësisë familjare bëhet duke paguar tarifën për çdo anëtarë të familjes që bëhet pronar –shfrytëzues.	20.00

10.2.3 Regjistrimi i Hipotekës

Regjistrimi i Hipotekave do të bëhet sipas vlerave të kërkesave (kredive) të përcaktuar me dokumentin e hipotekës

Nr.	Produkti	Çmimi / €
1	Kërkesa (kredia) në vlerën deri 30.000 €	20.00
2	Kërkesa (kredia) në vlerën prej 30.001 € e deri ne 50.000 €	30.00
3	Kërkesa (kredia) në vlerën prej 50.001 € e deri ne 100.000 €	60.00
4	Kërkesa (kredia) në vlerën prej 100.001 € e deri ne 200.000 €	90.00
5	Kërkesa (kredia) në vlerën prej 200.001 € e deri ne 500.000 €	120.00
6	Kërkesa (kredia) në vlerën prej 500.001 € e deri ne 1.000.000 €	240.00
7	Mbi vlerën e 1.000.000	400.00

10.2.4 Ndryshimi dhe fshirja e hipotekës

Nr.	Produkti	Çmimi / €
1	Ndryshimi i hipotekës së regjistruar	10.00
2	Për fshirjen e Hipotekës nga regjistri i të drejtave mbi pronën e paluajtshme lirohet nga pagesa	00.00

10.2.5 Regjistrimi i servituteve

Nr.	Produkti	Çmimi / €
1	Regjistrimi i të drejtës së servitutit në regjistrin e të drejtave mbi pronën e paluajtshme	30.00
2	Fshirja e servitutit nga regjistri	20.00
3	Modifikimi i të drejtës së servitutit	10.00

10.2.6 Regjistrimi i të drejtës së shfrytëzimit – qira mbajtja

Nr.	Produkti	Çmimi / €
1	E drejta e shfrytëzimit – qira mbajtje me kohëzgjatje deri në 10 vite për çdo njësi	10.00
2	E drejta e shfrytëzimit – qira mbajtje me kohëzgjatje mbi 10 vite per çdo njësi	20.00

- E drejta e shfrytëzimit – qira mbajtja me kohëzgjatje deri në 99 vite mund të regjistrohet duke zbatuar tarifën e përcaktuar sipas nenit 5 të këtij udhëzimi administrativ.

- Me rastin e bartjes së të drejtës së shfrytëzimit – qira mbajtjes ose nen qiranë tek personat e tretë paguhet tarifa e cila është përcaktuar me nenin 5 te këtij udhëzimi administrativ.

10.2.7 Korigjimi i të dhënave në regjistër

Nr.	Produkti	Çmimi / €
1	Nëse të dhënat që duhet të korrigjohen janë futur në regjistër sipas dokumentacionit të dorëzuar nga palët,korrigjimi i tyre behët sipas kërkesës së palës	30.00
2	Nëse të dhënat që duhet të korrigjohen janë futur në regjistër me veprimin e zyrës kadastrale komunale ose nga agjencia kadastrale e	00.00

	Kosovës atëherë korrigjimi i tyre bëhet sipas detyrës zyrtare	

10.2.8 Regjistrimi i të drejtave tjera

Nr.	Produkti	Çmimi / €
1	Regjistrimi i të drejtave, ngarkesave, barrës pronësore	20.00
2	Regjistrimi i vërejtjeve është	40.00
3	Shërbimet e tjera mbi pronën e paluajtshme e te cilat nuk janë përfshirë më dispozitat kësaj rregulloreje dhe udhëzimit Administrativ MMPH Nr 09/2020 do të regjistrohen duke paguar një tarifë fikse	50.00

10.3 Të hyrat nga qiradhënia e pronës së paluajtshme të komunës

Duke u mbështetur në nenin 20 paragrafi 1 dhe 4 të ligjit Nr. 03/L-049 për financat e pushtetit lokal në vijim paraqesim tarifat për shfrytëzimin me qira të pronës komunale.

10.3.1. Kërkesat për marrjen në shfrytëzim të përkohshëm për periudhë kohore deri në një (1) vit për tokën dhe objektet që janë pronë e komunës në territorin e komunës së Skenderajt, qytetarët e interesuar si persona fizik apo juridik me qëllim të zhvillimit të aktivitetit biznesor apo ndonjë aktiviteti tjetër të ligjshëm mund t'i drejtohen me shkresë organeve përkatëse të komunës përmes qendrës për shërbimin e qytetarëve në komunën / arkivit të komunës.

10.3.2.Të interesuarit sipas paragrafit 1 të këtij neni e marrin formularin e kërkesës në qendrën (zyrën) për shërbimin e qytetarëve në komunë / arkivin e komunës, e plotësojnë kërkesën sipas udhëzimeve në formular duke ia bashkangjitur edhe dokumentet tjera që kërkohen dhe ia përcjellin organeve përkatëse përmes zyrës së lartcekur.

10.3.3. Qiraja për shfrytëzimin e përkohshëm të tokës si pronë publike – komunale caktohet sipas zonave të përcaktuara me Rregulloren Komunale të Tatimit ne Prone për qytetin e Skenderajt.

10.3.4. Pagesa e qirasë për shfrytëzimin e pronës Komunale:

a) Qiraja për shfrytëzimin e pronës në zonën I-rë:	Çmimi për m²
Qiraja për lokale afariste	1.50 € / m² në muaj
Qiraja për terasat e lokaleve afariste	5.00 € / m² në vit
Qiraja e parkingjeve për lokale afariste	60.00 € në vit
Qiraja e parkingjeve për banoret rezidente	30.00 € në vit

b) Qiraja për shfrytëzimin e pronës në zonën II-të (periferia):	Çmimi për m²
Qiraja për lokale afariste:	1.00 € / m² në muaj
Qiraja për terasat e lokaleve afariste	2.00 € / m² në vit

Qiraja e parkingjeve për lokale afariste	30.00 € në vit
Qiraja e parkingjeve për banoret rezidente	15.00 € në vit

c) Qiraja për shfrytëzimin e pronës në zonat III-të (rurale):	Çmimi për m²
Qiraja për lokale afariste:	0.30 € / m² në muaj
Qiraja për terasat e lokaleve afariste:	0.30 € / m² në vit
Qiraja për veprimtari biznesore si: depove të materialit ndërtimor, gurëthyesit, sharrave e të tjera.	0.30 € / m² në vit

d) Shfrytëzimi i tokës bujqësore	50.00 € / ha në vit

Pagesa e qirasë për shfrytëzim të përkohshëm e pronës duhet të behet që në fillim të shfrytëzimit pra me nënshkrimin e marrëveshjes – kontratës.

10.4 Pagesa e shfrytëzimit të pronës publike sipas procedurave të hapura të përcaktuara në ligjin nr. 06/L-092 për dhëniën në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës se paluajtshme të Komunës :

10.4.1 Dhënia në shfrytëzim afatshkurtër e pronës Komunale (për sipërfaqet e ndërtuara) përmes proceduarve të hapura-konkurruese fillon me çmimet:

Zona I.....5.00 €/ m² në vit
Zona II .....3.50 €/ m² në vit
Zona III .....2.00 €/ m² në vit

10.4.2 Dhënia ne shfrytëzim afatgjatë e pronës Komunale behet përmes procedurave te hapura- konkurruese fillon prej 21% te vlerës se sipërfaqes ndërtuese të çmimit te përcaktuar me rregulloren Komunale të datës 27.09.2010 me numër 110-70 dhe plotësim ndryshimin e datës 28.02.2017 Nr.03-110101-001740/17

10.4.3 Të gjitha pronat Komunale qe jepen ne shfrytëzim me qellim te hapjes se veprimtarive prodhuese lirohen nga qiraja (pa pagesë).

10.4.4 Me qira për shfrytëzim të përkohshëm të pronës Komunale ngarkohen edhe shfrytëzuesit momental ilegal, por pa të drejtën e fitimit të pronësisë mbi këtë pronë, e cila do të definohet me Aktvendimin e ngarkesës, dhe njëherit nuk mund ti pengojnë as organet kompetente Komunale për realizimin e vendimeve në zbatimin e planit urbanistik të Komunës.

Çmimorja e qirasë për këta shfrytëzues:

Zona I .....2.00 €/ m² ne muaj,
Zona II .....1.50 €/ m² ne muaj,
Zona III ..... 0.70 €/ m² ne muaj.

Neni 11
DREJTORIA PËR SHËRBIME PUBLIKE

11.1 Tarifat në sferën e shërbimeve publike

Nr.	EMËRTIMI (i ngarkesave, kompensimeve dhe taksave ne shërbime)	Euro (€)
1	Kërkesë për dalje në terren nga PTK-ja	100.00
2	Kërkesë për dalje në terren nga KEK-u	100.00
3	Kërkesë për dalje në terren nga subjektet tjera si motra	100.00
4	Për hyrje ne Shesh të automjeteve për furnizim me mjete monetare për bankat, për 1 vite	250.00
5	Për ngarkim dhe shkarkim të mallrave, para lokaleve afariste qe e shfrytëzojnë hapësirën publike(rrugë trotuare), për 1 vite	30.00
6	Për çdo ndryshim të rendit të udhëtimit, nga ana e kompanive të transportit publik të udhëtareve	50.00
7	Leje operimi për auto-taxi tarifa — vjetore	35.00
8	Vazhdimi i lejes për auto-taxi, tarifa vjetore	30.00
9	Leje pune për kombibus - taxi, tarifa vjetore	40.00
10	Vazhdimi i lejes për kombibus-taxi, tarifa vjetore	35.00
11	Takse mujore për vendosjen e ATM-ve nga instuticionet bankare	100.00
12	Takse vjetore për vendosjen e antenave për rrjete telefonike, Tv dhe Internet	100.00
13	Takse vjetore për shfrytëzimin e shtyllave elektrike te ndriçimit publik	500.00

11.2 Tarifat për tregun e gjelbër në Skenderaj

1	Lokali	50€ mujore
2	Tezga	20€ mujore
3	Kamion (5-12) ton	10€ ditore
4	Kombi	5€ ditore
5	Vetura	3€ ditore
6	Traktor me dru	3€ ditore
7	Kamion me mobile deri në 10 ton	10€ ditore
8	Kerret në shitje	2€ ditore
9	Bylmet (0,5 -10) kg	0,50€ ditore
10	Bylmet (10-50) kg	1€ ditore
11	Miell, patate, fasule, rasat deri në 50kg	1€ ditore
12	Pjesë për amvisni	3€ ditore
13	Pjesë për bujqësi	5€ ditore
14	Të tjera , çmimi caktohet për m^2	1€ ditore

Përjashtim nga te gjitha këto të listuar ne tabelë prej pagese lirohen, Familjet e Dëshmoreve, Invalidët e Luftës se UÇK-së dhe Veteranët, anëtaret e familjes se ngushtë të këtyre kategorive (prindërit, bashkëshortet dhe fëmijët deri në moshën 18 vjeçare, por nëse janë në studime deri në moshën 26 vjeçare), si dhe te gjitha kategoritë tjera qe me Legjislacionin ne Fuqi janë te liruara nga ky lloj i tarifave.

11.3 Taksa komunale për ndërhyrje ne infrastrukturën komunale

Çdo person qe ndërhyn ne infrastrukturën komunale sipas veprimeve to përcaktuara me ketë nene obligohet to ktheje atë infrastrukture ne gjendjen to mëparshëm dhe paguaj takse si ne vijim:

Nr.	Emërtimi	Euro
1	Groposja për kyçje ne rrjetin e kanalizimit, to ujësjellësit dhe çdo rrjet tjetër nëntokësor ne rruge to asfaltuar prej 0-30 m. Rruga te kthehet ne gjendjen paraprake.	100.00
2	Groposja për kyçje ne rrjetin e kanalizimit, to ujësjellësit dhe çdo rrjet tjetër nëntokësor ne rruge to asfaltuar mbi 30 m. Rruga te kthehet ne gjendjen paraprake	150.00

Taksa sipas paragrafit 1 te këtij neni paguhet para ndërhyrjes ne infrastrukturën komunale.
Taksa mbi vendosjen e panove reklamuese

11.4 Çdo shoqëri tregtare qe ekspozon pano reklamuese ne hapësirën publike, paguan si ne vijim:

Nr.	Emërtimi	Euro (€)
1	Për panot reklama (Lampost) te vendosura neper shtyllat e ndriçimit publik deri ne 1m^2 — Takse Mujore	5.00 cope
2.	Për panot reklama te ndryshme afariste ne hapësirën tokësore me sipërfaqe deri ne 4 m^2 - Takse Vjetore	500.00
3	Për panot reklama te ndryshme afariste (Bilborda dhe Citylight) ne hapësirën tokësore me siperfaqe me te madhe se 4m^2 - Takse Vjetore	1,200.00
4	Për panot reklama te ndryshme afariste (Citylight) ne hapësirën tokësore me siperfaqe deri 2m^2 - Takse Vjetore	300.00
5	Vendosja e transparenteve reklamuese për m^2 - Takse Mujore	15.00
6	Vendosja e shpalljeve dhe publikimeve te përkohshme, ne muret dhe objektet tjera- Taksa Vjetore (Propozim i drejtorisë).	25.00
7	Vendosja e reklamave ne muret e objekteve publike dhe private – Taksa vjetore	100.00

1.Çdo shoqëri tregtare obligohet qe te njoftoje Komunën para vendosjes së panosë duke specifikuar llojin dhe madhësinë e panosë se vendosur.
2.Pagesa e taksës komunale për vendosjen e panove sipas kësaj tabele behet para datës se vendosjes se panos.

11.5 Tarifat e Parkingut Publik të menaxhuar nga Drejtoria e Shërbimeve Publike

Çmimet përcaktohen në bazë të relacioneve të autobusëve dhe kapacitetit të ulëseve, për secilën hyrje, ndërsa për veturat dhe mjetet tjera përcaktohen në bazë te peshës se automjeteve.

11.6 Autobusët e relacionit urban:

- Autobusët mbi 28 ulëse 2.5 €,
- Autobusët deri 28 ulëse 2 €,
- Autobusët deri 18 ulëse 1.5 €.

11.7 Autobusët e relacionit nderurban dhe periferi:

- Autobusët mbi 28 ulëse 2 €,
- Autobusët deri 28 ulëse 1.5 €,
- Autobusët deri 18 ulëse 1 €.

11.8 Veturat/Automjetet deri në 3.5 tonë 1.00 €.
11.9 Veturat/Automjetet mbi 3.5 tonë 2.00 €.

Neni 12
DREJTORIA E INSPEKTORIATIT
Tarifat Inspektuese

12.1 Tarifa inspektuese për kafshë të trasha, si p.sh. lopë kuaj etj.	**5.00**
12.2 Tarifa inspektuese për kafshë të imëta si p.sh. delet, dhit, qentë, macet	**1.00**
12.3 Vërtetimi i lëshuar për kafshë të imëta nga stacioni i veterinës	**1.00**

Pëlqimi për lokale afariste

12.4 Tarifa për lokalin deri në 20 m^2 shuma prej	**20.00**
12.5 Tarifa për lokalin nga 20 deri në 50m2 shuma prej	**30.00**
12.6 Tarifa për lokalin nga 50m2 deri në 100m2 shuma prej	**40.00**
12.7 Tarifa për lokalin mbi 100m2 shuma prej	**150.00**

12.8 Tarifa për dhënien e pëlqimit për plotësimin e kushteve higjenik-sanitare shuma prej **100 €**

12.1 Gjobat për kyçja pa leje në rrjetin e ujësjellësit

1	Personi fizik	250-500
2	Personi juridik	500-1000

12.2 Gjobat për kyçja pa leje në rrjetin e kanalizimit publik

1	Personi fizik	150-300
2	Personi juridik	300-500

12.3 Derdhja e ujërave të zeza në hapësirën publike

1	Personi fizik	150-300
2	Personi juridik	250-500

18.3.1 Derdhja e vajrave motorike

1	Personi fizik	100-200
2	Personi juridik	200-400

12.4 Gjobat për Hedhjen e mbeturinave (UA 06/2018 I MMPH neni 16)

1	Hedhja e cigares në rrugë, çamçakëzit etj.	20.00
2	Hedhja e ambalazhesh dhe mbeturina (qelq, Letër, konaqe, mbeturina ushqimore etj) në sipërfaqe publike	30.00
3	Hedhja e mbeturinave jashtë kontejner, shkapërderdh (mbet. organike, qelqi letre etj)	40.00
4	Hedhja e mbeturinave (cigare, letrës, plastike kanaqe etj) nga automjeti	50.00
5	Hedhja e mbeturinave (cigare, letrës, plastike kanaqe etj) nga ballkoni,	70.00

	në puseta kanalizimi, ngjyra etj	
6	Hedhja e mbeturinave jashtë kontejneri apo vendeve të përcaktuar të të gjitha natyrave të mbeturinave	90.00
7	Hedhja e çfarëdo mbeturine në përroskat e lumenjve, liqeneve kanalizimeve apo tjera	100.00
8	Djegia e mbeturinave	100.00

12.5 Për keqpërdorimin e ujit të pijshëm

1	Personi fizik	100-200
2	Personi juridik	500-1000

12.6 Gërvishtja, prerja, lakimi, ndotja ose dëmtimi në çfarëdo forme i objekteve me interes të përgjithshëm siç janë : ndriçimi publik, shenjat e komunikacionit dhe të gjitha hapësirave publike

1	Dëmtimi i shtyllës ndriçuese (komplet)	350-500
2	Dëmtimi i një bime dekorative	100-200
3	Dëmtimi i ulëseve dhe pjesëve përcjellëse të parqeve (ndotja, thyerja dhe dëmtime tjera)	100-500
4	Dëmtimi i rrethojave për mbrojtjen e gjelbërimit për ml	30.00
5	Dëmtimi i pronave dhe objekteve publike, pajisjeve sportive në objektet të hapur dhe të mbyllura	150-500
6	Hyrja dhe parkimi në hapësirat publike me mjete motorike (trotuare, sheshe, stadiume, fushat sintetike, parqet, poligonet sportive, etj.)	50-500

12.7 Mirëmbajtja e hapësirave në pronat publike dhe private

12.7.1 Gjate sezonit verore kërkohet nga pronaret ose shfrytëzuesi mirëmbajta dhe rregullimi i hapësirave publike dhe private me gjelbërim dhe lule, pastrimit, larje, ujitje, kositje etj.

1	Personi fizik	70-150
2	Personi juridik	200-500

12.7.2 Gjate sezonit dimëror kërkohet nga pronaret ose shfrytëzuesi mirëmbajta e hapësirave publike dhe private duke larguar boren nga trotuaret dhe hapësirat para lokaleve dhe objekteve

1	Personi fizik	100-200
2	Personi juridik	500-1000

12.8 Kalimi (shkelja) nëpër sipërfaqet e gjelbëruara të parqeve dhe hapësirave të tjera të ndaluara publike

1	Kalimi (shkelja) dhe parkimi me automjet në sipërfaqet e gjelbëruara të parqeve dhe hapësirave të tjera të ndaluara publike	100-500

12.9 Larja e veturave dhe automjeteve të tjera në trotuar dhe rrugë

1	Personi fizik	30.00
2	Personi juridik	100.00

Neni 13

Gjobat për dëmtimin, shkatërrimin, gërvishtjen, prerjen, lakimin

E kamerave

Gjoba për personin juridik **500.00**

Gjoba për personin fizik **300.00**

Shenjat e komunikacionit

Gjoba për personin juridik **300.00**

Gjoba për personin fizik **150.00**

Pritoret (kabinat) e stacioneve

Gjoba për personin juridik **500.00**

Gjoba për personin fizik **150.00**

Gjobat për dëmtimin e varrezave:

13.1 Për dëmtimin e lapidareve

Personat fizikë..... **200.00**

Personat juridik..... **400.00**

13.2 Për dëmtim të pllakave përkujtimore të varrezave

Personat fizikë..... **100.00**

Personat juridik..... **200.00**

13.3 Për zjarrvënës të qëllimshme në sipërfaqet e varrezave,

Personat fizikë..... **100.00**

Personat juridik..... **100.00**

13.3 Ekspozimi i produkteve ushqimore ne rrezet e diellit

Personat juridik..... 100.00-300.00

13.4 Ndërsa për gjobat për dispozitat ndëshkimore për masat mbrojtës kundër zjarrit duhet respektuar Ligjin për Mbrojtje nga Zjarri nr. 04/L-012, përkatësisht kreun e VII, nenet 34, 35 dhe 36

Neni 14

DREJTORIA E SHËNDETËSISË DHE MIRËQENIES SOCIALE

Çmimorja për tarifat dhe ngarkesat në DSHMS

Nr.	**EMËRTIMI** (i ngarkesave, kompensimeve dhe taksave në shërbime)	Euro(€)
1.	Vërtetimi për nxënësit dhe studentet për shtetet e jashtme	5.00 €
2.	Vërtetim mbi gjendjen shëndetësore të punëtorëve në shtetet e jashtme	10.00 €
3.	Vërtetime të ngjashme që nuk ceken në pikën 1 dhe 2.	10.00 €

Çmimorja për tarifat dhe ngarkesat në QPS

Nr.	**EMËRTIMI** (i ngarkesave, kompensimeve dhe taksave në shërbime)	Euro(€)
1.	Vërtetimi për zotësi veprimi (armëmbajtje, veprimtari biznesi):	5.00
2.	Vërtetimet lirim nga shtetësia e Kosovës:	5.00
3.	Vërtetim pranim të shtetësisë së Kosovës	5.00
4.	Mendime profesionale	5.00
5.	Pëlqim për martesë para moshës madhore	10.00

6.	Regjistrim i me vonshëm i fëmiut	5.00
7.	Konkluza dhe konstatime të ndryshme	5.00
8.	Ushtrim i te drejtës prindërore, rregullim të dokumentacioneve	5.00
9.	Pëlqim për udhëtim për te mitur	5.00
10.	Vërtetimin qe familja nuk është shfrytëzuese e A.S (nga kjo tarifë lirohen familjet në asistencë sociale, familjet e dëshmorëve, invalidët e luftës, nxënës dhe studentë deri në moshën 26 vjeçare)	5.00

Çmimorja për tarifat dhe ngarkesat në shërbimet e QKMF-së

Nr.	**EMËRTIMI** (i ngarkesave, kompensimeve dhe taksave në shërbime)	Euro(€)
1.	Ekzaminimi mjekësor në punkt, QMF ose në QKMF, pa analiza laboratorike ose pa procedura plotësuese diagnostiko me aparaturë	1.00
2.	Ekzaminimi specialistik në QMF/QKMF me udhëzim të Mjekut të Familjes	2.00
3.	Ekzaminimi specialistik në QMF/QKMF pa udhëzim të Mjekut të Familjes	5.00
4.	Ekzaminimi në shtëpi, përpos në rastet emergjente	6.00
5.	Medikamenti nga Lista Esenciale, ofruar në barnatoren publike	0.30
6.	Ultrazëri standard	2.00
7.	Radiografia	2.00
8.	EKG	0.50
9.	Analizat laboratorike – vetëm hemogrami dhe urina	1.00
10.	Analizat laboratorike (komplet) biokimike (5 parametra)	3.00
11.	Caktimi i sheqerit në gjak me glikometër sipas kërkesës së shfrytëzuesit të shërbimeve shëndetësore	1.00
12..	Shpëlarja e veshit	1.00
13.	Dhënia e injeksionit intramuskular në shtëpi, përpos në rastet emergjente	1.00
14.	Dhënia e injeksionit intravenoz në shtëpi, përpos në rastet emergjente	1.00
15.	Dhënia e infuzionit	1.00
16.	Përpunimi i plagëve me qepje dhe pastrimi deri në shërimin e plagës (vetëm në vizitën e parë)	3.00
17.	Trajtimi ditor me infuzione në institucionin shëndetësor	1.00
18.	Dhënia e raportit mjekësor, vërtetimit apo dokumentit tjetër në bazë të kërkesës së shfrytëzuesit të shërbimeve shëndetësore	5.00
19.	Certifikata shëndetësore për punësim	15.00
20.	Ofrimi i shërbimeve shëndetësore gjatë aktiviteteve sportive, etj-për një orë	25.00

Certifikatat shëndetësore për edukim dhe shkollim, lirohen nga pagesa në sektorin publikë, me përjashtim të moshës mbi 26 vjet dhe shtetasit e huaj, konform Udhëzimit Administrativ për Certifikatat Shëndetësore Nr.04/2013, sipas Shtojcës 1 "Çmimorja për Certifikatat Shëndetësore".

Shtetasit e huaj dhe bartësit e sigurimeve të huaja shëndetësore do të paguajnë shërbimet e ofruara pesë herë më shtrenjtë se sa shtetasit e Republikës së Kosovës, për një shërbim që ka bashkë pagesë në lartësi prej 2€ shtetasi i huaj ose bartësi i sigurimit të huaj shëndetësor do të paguaj 10€.

Çmimorja për tarifat dhe ngarkesat në shërbimet stomatologjike

Nr.	**EMËRTIMI** (i ngarkesave, kompensimeve dhe taksave në shërbime)	Euro(€)
1.	Vizitë e parë stomatologjike	1.00
2.	RTG i dhëmbit	1.50
3.	Mbushje e përhershme me amalgamë	4.00
4.	Mbushje e përhershme me kompozitë	5.00
5.	Shërimi biologjik i dhëmbit me mbushje të përhershme (amalgamë apo kompozitë)	5.00
6.	Amputimi vital i pulpës me mbushje të përhershme (amalgamë apo kompozitë)	6.00
7.	Extirpimi vital i pulpës me mbushje të përhershme (amalgamë apo kompozitë)	6.00
8.	Amputimi mortal i pulpës me mbushje të përhershme (amalgamë apo kompozitë)	6.00
9.	Extirpimi mortal i pulpës me mbushje të përhershme (amalgamë apo kompozitë)	6.00
10.	Terapia e kanalit të infektuar me mbushje të përhershme (amalgamë apo kompozitë)	6.00
11.	Rindërtimi konservativ i dhëmbit me mbushje të përhershme	6.00
12.	Revizioni i mbushjes së kanalit të rrënjës	1.00
13.	Fluorizimi i dhëmbëve sipas seancave	1.00
14.	Vulosja e fisurave	1.00
15.	Mënjanimi i depozitimeve të buta	1.00
16.	Mënjanimi i depozitimeve të forta (Heqja e gurëzve të dhëmbëve me ultratingull)	3.00
17.	Kiretazha e xhepave parodontal (një dhëmbë)	1.00
18.	Nxjerrja e dhëmbit	1.50
19.	Incizioni intra dhe ekstra oral	1.50
20.	Heqja e kurorës me anë të prerjes	1.00
21.	Riparimi i protezës (ngjitja)	1.50

Shtetasit e huaj dhe bartësit e sigurimeve të huaja shëndetësore do të paguajnë shërbimet e ofruara pesë herë më shtrenjtë sesa shtetasit e Republikës së Kosovës, për një shërbim që ka bashkë – pagesë në lartësi prej 2€ shtetasi i huaj ose bartësi i sigurimit të huaj shëndetësor do të paguaj 10€.

Nga të gjitha këto tarifa lirohen familjet në asistencë sociale, familjet e dëshmorëve, invalidët e luftës, nxënës dhe studentë deri në moshën 26 vjeçare.

Neni 15
DREJTORIA PËR ARSIM

Tarifat në sferën e arsimit

Nr	**EMËRTIMI** **(i ngarkesave, kompensimeve dhe taksave në shërbime)**	Euro(€)
1.1	Tarifa mujore për një fëmijë në Institucione parashkollore publike	40.00
1.2	Tarifa mujore për 2 fëmijë në Institucione parashkollore publike, për secilin fëmijë	30.00
1.3	Tarifa për regjistrimin e vitit shkollor për arsim dhe aftësim për të rritur	100.00
1.4	Tarifa për provimet përfundimtare /certifikata-diploma	50.00
1.5	Tarifa për dokumentet duplikat për shkollat e mesme për çdo dokument paguhet	1.00
1.6	Tarifa për diplomë duplikat për shkollat e mesme	5.00
1.7	Regjistrimi i Institucioneve parashkollore private	150.00
2.1	Personat e liruar/a nga pagesat në shërbimet e Drejtorisë së Arsimit	
2.2	Fëmijët me Nevoja të Veçanta Arsimore (me Vendim të Komisionit për Vlerësim Pedagogjik të Fëmijëve me nevoja të Veçanta)	0.00

Neni 16
DREJTORIA PËR KULTURË, RINI DHE SPORT

Tarifat në sferën e kulturës, rinisë dhe sportit

	EMËRTIMI (i ngarkesave, kompensimeve dhe taksave në shërbime)	Hapësira	Norma tatimore në Euro/ %
1.	Për çdo manifestim të kontraktuar në shtëpinë e kulturës	Salla e madhe Q. K.	30%
2.	Shfrytëzimi i sistemit të zërimit	Jashtë objektit	30.00
3.	Për fushata të partive politike	Salla e madhe Q. K.	80.00
4.	Për fushata të partive politike	Salla e vogël Q. K.	50.00
5.	Shfaqje të ndryshme nga biletat shituara	Salla e madhe	30%
6.	Çmimi i biletës për shfaqjen e filmave	Salla e madhe	1.00
7.	Çmimi i biletave për ndeshje sportive-caktohen në marrëveshje me klubet	Fusha/futbolli it	-
8.	Anëtarësia vjetore për leximin e librave	Biblioteka	2.00

9.	Stërvitjet e ekipeve sportive private pa ndriçim	Palestër	20.00
10.	Stërvitjet e ekipeve sportive private me ndriçim	Palestër	25.00
11.	Për zhvillimin e ndeshjeve private pa bileta	Palestër	50.00
12.	Për zhvillimin e ndeshjeve private me bileta	Palestër	30%
13.	Për ngjarjet komerciale, panaire ekspozita e të ngjashme për një ditë	Palestër	200.00
14.	Për koncerte të ndryshme nga inkasimi i biletave	Palestër	30%
15.	Të gjitha klubet jashtë komunës për një ditë	Palestër	100.00
16.	Qëllimet rekreative për një orë pa ndriçim	Palestër	20.00
17.	Qëllimet rekreative për një orë me ndriçim	Palestër	25.00
18.	Për fushata të Partive politike për një ditë	Palestër	150.00
19.	Për shfrytëzimin e palestrës nga organizatat e ndryshme për koncerte apo shfaqje të ndryshme për një ditë	Palestër	150.00
20.	Për vendosjen e reklamave në fushën e basketbollit dhe volejbollit në parket në bazë mujore	Palestër	150.00
21.	Në gjysmë rrethin e reketit të fushës së basketbollit në bazë mujore	Palestër	70.00
22.	Ne hapësirën e 6 metërshit të fushës së hendbollit 2 x 0.60 m në bazë mujore	Palestër	70.00
23.	Në hapësirën e fushës së basketbollit, volejbollit dhe hendbollit 3 x 0.60 m në bazë mujore	Palestër	70.00
24	Në pjesën veriore (A dhe B)të palestrës në bazë mujore	Palestër	35.00
25.	Në pjesën jugore (C dhe D) të palestrës në bazë mujore	Palestër	35.00
26.	Në pjesën lindore dhe perëndimore në bazë mujore për m^2	Palestër	25.00

Lirohen nga pagesa:
-Tubimet përkujtimore dhe humanitare
-Tubimet e organizuara nga Komuna e Skenderajt,
-Te gjitha aktivitetet e organizuara nga DKRS,
-Shoqatat me aftësi te kufizuara,
-Shoqatat e dalura nga lufta, familjet e dëshmorëve dhe invalidët e luftës
-Bashkësitë fetare.

Neni 17
DISPOZITAT NDËSHKIMORE

Shkelësit e kësaj rregulloreje do të gjobiten :

a) Me dënime prej 200 € (pas vërejtjes me shkrim) do të dënohen të gjitha subjektet afariste, personat fizik dhe ata juridik nëse:

- Veprojnë pa leje të punës;
- Nëse shet mallra me afat të skaduar;
- Nëse nuk dëshmojnë prejardhjen e mallrave;
- Nëse nuk prezantojnë dokumentacionin qe kërkohet nga inspektorët.

Me dënime prej 150 €, nëse subjekti afarist (personat fizik apo juridik) fillojnë punën pa pëlqimin mbi kushtet higjenik – sanitare , teknike të punës dhe të mbrojtjes në punë.

b) dënim prej 100 € nëse subjekti afarist nuk i vendos çmimet (për secilin artikull të ndryshëm).

c) Dënimi prej 400 € pas vërejtjes së dytë të paraparë në pikën (a) të këtij neni.

d) Pas vërejtjes së tretë mbyllje dhe ndërprerje të përkohshme të veprimtarisë.

e) Dënimi prej 100 € nëse nuk vë firmën në vendin e duhur (nëse nuk ka shënuar emrin e mbiemrin e pronarit të subjektit afarist, emrin e firmës si dhe emërtimi i rrugës ku gjendet lokali).

f) Dënimi prej 20 € shqiptohet ndaj personit përgjegjës të personit juridik nëse e ka të ekspozuar orarin e punës, nuk i përmbahet orarit të punës, të cilin ai e ka caktuar në përputhje me Rregulloren komunale për fillimin dhe mbarimin e orarit të punës.

h) Dënimi prej 100 € subjekti afarist nëse nuk e ven flamurin për festat zyrtare ose ditë zie të shpallura nga organi kompetent i Republikës së Kosovës.

i) Dënimi prej 100 € nëse:
- Nëse personi juridik nuk i ven çmimet në vend të dukshëm , nuk u dorëzon blerësve fatura ose nuk e ve firmën në vend të duhur.

j) Dënimi prej 20€ nëse:

- Punëtori i cili punon në lokal nuk e ka uniformën përkatëse dhe nuk ka pastërtinë e duhur si dhe .
- Për pa rregullsitë tjera të konstatuara nga inspektorët.

k) Shqiptimi i sanksioneve kundërvajtësi të përcaktuara në këtë Rregullore bëhet në përputhje me ligjin përkatës për kundërvajtjet.

Implementues : Drejtoria për Shërbime Publike.

Neni 18
DISPOZITAT E VEÇANTA

Gjobat
1 Gjobat nga trafiku;

Gjobat e shqiptuara për shkelje kundërvajtjeje në trafik brenda territorit të komunës, janë të hyra vetanake dhe i takojnë Komunës. Transferet bëhen në përputhje me LMFPP-në dhe do t'i përfshijnë pagesat që bëhen përmes policisë së Kosovës dhe gjykatave, si rezultat i vendimeve gjyqësore.

2 Gjobat për shkeljen e rregulloreve lokale;
Rregulloret lokale, të miratuara nga kuvendi i komunës së Skenderajt, përmbajnë dispozitat ndëshkuese për shkeljen e dispozitave nga bartësit konkretë. Lartësia e gjobës është e bazuar në proporcion me fajësinë e bërë nga shkelësi i dispozitave të rregulloreve komunale.

3 Për të gjitha taksat, ngarkesat dhe gjobat e caktuara me këtë rregullore, e që nuk janë të parapara me këtë rregullore, do të aplikohen taksat, ngarkesat dhe gjobat e caktuara me ligj dhe udhëzime përkatëse.

Neni 19

Bashkë pagesat për arsim dhe shëndetësi;

Të gjitha bashkë pagesat, tarifat dhe taksat për shërbime komunale të arsimit dhe shëndetësisë, konsiderohen si të hyra vetanake të institucionit përkatës arsimor dhe shëndetësor të Komunës. Trajtimi, kontabiliteti, raportimi, monitorimi dhe verifikimi i këtyre bashkë pagesave do të bëhet në përputhje me LMFPP–në.

Neni 20
DISPOZITAT KALIMTARE DHE TË FUNDIT

Në të gjitha rastet që nuk janë të rregulluara me këtë rregullore, apo në rast konflikti dhe mospërputhje të dispozitave të kësaj rregulloreje me legjilacionin në fuqi dhe aktet nënligjore, do të zbatohen dispozitat e Ligjeve dhe akteve nënligjore përkatëse të aplikueshme në Republikën e Kosovës.

Neni 21

Kjo rregullore mund të ndryshohet me procedurë të njëjtë me atë të miratimit nga Kuvendi i Komunës së Skenderajt.

Neni 22

Me hyrjen në fuqi të kësaj rregulloreje, shfuqizohet rregullorja komunale për taksa, tarifa, ngarkesa dhe gjoba nr. 01-110/04-0000142/17, të datës 06.01.2017, e plotësuar ndryshuar me rregulloren nr.01-110/04-0044236/18 të datës 03.08.2018, për taksa, tarifa, ngarkesa dhe gjoba në Komunën e Skenderajt për vitin 2018.

Neni 23

Pas miratimit nga Kuvendi i Komunës së Skenderajt, kjo rregullore hyn në fuqi 15 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, dhe 7 ditë pas publikimit në web-faqen zyrtare të Komunës së Skenderajt.

KRYESUESJA E KUVENDIT
Znj. Valdrina Spahiu

Nr./Br./No. 21552
Nr. i fq./Br. Str./No. pg. 4
Data/Datum/Date: 21.06.2022

Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada – Government

Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural
Ministarstvo Poljoprivrede, Šumarstva i Ruralnog Razvoja
Ministry of Agriculture, Forestry and Rural Development

Departamenti Ligjor/Pravni Departament/ Legal Departament

Për:	Fadil Nura, Kryetari i Komunës së Skenderaj Adelina Spahiu, Kryesuesja e Kuvendit të Komunës së Skenderaj	
Kopje:	Venera Çerkini, Zv. Sekretare e Përgjithshme, MAPL Besim Myrtezani, Zv. Udhëheqës i Departamentit Ligjor dhe Monitorim të Komunave Xhevat Tafa, Udhëheqës i Divizionit për Monitorim të Komunave Kujtim Aliu, Zyrtar i Lartë për Monitorim të Komunave	
Përmes:	Faton Peci, Ministër i MBPZHR-së Blerim Hasani, Sekretari i Përgjithshëm i MBPZHR-së	
Nga:	Isah Rudaku, Zv. Drejtor i Departamentit Ligjor, MBPZHR	Datë:14.06.2022 Ref.10.122/2022
Zyrtarët përgjegjës: **1. Zyrtari konfirmues i vlerësimit ligjor** **2. Zyrtari hartues i vlerësimit ligjor**	Isah Rudaku, Zv. Drejtor i Departamentit Ligjor, MBPZHR	
Lënda:	Përgjigje në Kërkesë për rishqyrtimin e ligjshmërisë së aktit të Komunës së Skenderajt	
Lloji i aktit:	Rregullore për Taksa, Tarifa, Ngarkesa dhe Gjoba Komuna Skenderaj	

I/e nderuar Kryetar,
I/e nderuar Kryesues,

Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, në pajtim me Rregulloren (QRK) Nr. 06/2021 për ndryshimin dhe plotësimin e rregullores (QRK) Nr.10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave më datë 08.06.2022, ka pranuar nga MAPL aktin e miratuar nga kuvendi i komunës së Skenderajt Rregullore Nr.01-110/05-0025382/22 për taksa, tarifa, ngarkesa dhe gjoba, të miratuar me datën 29.04.2022 si dhe i parashtruar për shqyrtim në MAPL, me datën 06.06.2022.

Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural , pas shqyrtimit të ligjshmërisë së aktit në fjalë, dhe në pajtim më Nenin 4 të Rregullores (QRK) Nr. 06/2021 për ndryshimin dhe plotësimin e rregullores (QRK) Nr.10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave, kërkon nga kuvendi i komunës së Skenderajt.

Rishqyrtimin e Ligjshmërisë së Aktit

Rregullorja Nr.01-110/05-0025382/22 për taksa, tarifa, ngarkesa dhe gjoba të miratuar nga Kuvendi i Komunës së Skenderaj, me datën 29.04.2022. I parashtruar për shqyrtim në MAPL më datë: 06.06.2022

Rregullorja Nr.01-110/05-0025382/22 për taksa, tarifa, ngarkesa dhe gjoba e miratuar nga Kuvendi i Komunës së Skenderaj, është në pajtim me:

- Udhëzimin Administrativ Nr.41/2006 për Ndërrimin e Destinimit të Tokës Bujqësore, të datës 27.12.2006.

- Udhëzimin Administrativ MA-NR.12/2005 për caktimin e çmimeve – taksave për shfrytëzimin e produkteve pyjore-drunore, jo drunore dhe shërbime profesionale teknike, të datës 16 maj 2005, dhe

- Udhëzimin Administrativ MA-NR.09/2007 për shfrytëzimin e kullotave të datës 30.03.2007.

Ministria përgjegjëse për bujqësi informon se taksat për shërbimet për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore, për caktimin e çmimeve – taksave për shfrytëzimin e produkteve pyjore-drunore, jo drunore dhe shërbime profesionale teknike dhe për shfrytëzimin e kullotave, janë të harmonizuar me legjislacion përkatës.

Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, pas shqyrtimit të përmbajtjes së aktit të komunës si më sipër, vlerëson se akti i komunës **është në pajtim me dispozitat e legjislacionit në fuqi**.

Ministria e *Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural*, mbetet në dispozicion të MAPL dhe komunës për çfarëdo sqarimi të mëtejmë në lidhje me këtë vlerësim.

Me respekt,

Njesia Org.: 2.2
Org.Jedinica:
Org Unit:
Nr.i faqes: -30-
Broj strana:
No.pages:
Nr.Prot: 05-3006
Broj prot:
Prot.No:
Data: 17/06/2022
Date:
Prishtinë / a

Republika e Kosovës

Republika Kosova - Republic of Kosovo

Qeveria – Vlada - Government

Ministria e Shëndetësisë-Ministarstvo Zdravstvoa-Ministry of Health

Departamenti Ligjor/Pravni Departament/Legal Departament

Për:	Z. Fadil Nura, Kryetar i Komunës së Skenderajt, Znj. Adelina Spahiu, Kryesuese e Kuvendit të Komunës së Skenderajt,	
Kopje:	Z. Elbert Krasniqi, Ministër në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal, Znj. Venera Çerkini, Zëvendësuese e Sekretarit të Përgjithshëm, MAPL, Njësia për Administrimin e Dokumentëve në MAPL	
Përmes:	Dr. Rifat Latifi, Ministër i Shëndetësisë Dr. Naim Bardiqi, Sekretar i Përgjithshëm në MSH	
Nga:	Naim Baftiu, Drejtor i Departamentit Ligjor në MSH	
Lënda:	Konfirmimi i ligjshmërisë së aktit të Komunës së Skenderajt	Data: 09.06.2022
Lloji i Aktit:	Rregullore e Kuvendit të Komunës	

I nderuar Kryetar Z. Nura,
E nderuara Kryesues Znj. Spahiu,

Në pajtim me Rregulloren e Qeverisë së Republikës së Kosovës Rregulloren (QRK) Nr. 06/2021 për ndryshimin dhe plotësimin e rregullores (QRK) Nr.10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të Komunave, e në bazë të kompetencave ligjore të ministrisë të përcaktuara me ligjet bazike dhe Rregulloren e Qeverisë Nr. 02/2021 për fushat dhe përgjegjësitë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, Departamenti Ligjor i Ministrisë së Shëndetësisë ka pranuar për shqyrtim të detyrueshëm të ligjshmërisë ashtu siç parashihet me nenin 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale aktin komunal si në vijim:

Rregulloren Nr. 01-110/05-0025382/22, për taksa, tarifa, ngarkesa dhe gjoba për vitin 2022.
Dokument i miratuar me dt. 29.04.2022.
E parashtruar për shqyrtim në MAPL, me datën 06.06.2022
I dërguar për shqyrtim në MSh, me datë: 08/06/2022

Ministria e Shëndetësisë, pas shqyrtimit të përmbajtjes së aktit të komunës si më sipër, vlerëson se akti i komunës **është në pajtueshmëri të plotë me dispozitat e legjislacionit në fuqi** .

Ministria e Shëndetësisë, pas shqyrtimit të përmbajtjes së aktit të komunës Rregulloren Nr. 01-110/05-0025382/22, për taksa, tarifa, ngarkesa dhe gjoba për vitin 2022, konstaton se organi komunal ka vepruar në pajtueshmëri me Udhëzimin Administrativ Nr.04/2007 Mbledhja dhe shfrytëzimi i mjeteve nga bashkë-pagesat e shfrytëzuesve të shërbimeve shëndetësore dhe të hyrave vetanake të Institucioneve Shëndetësore, (Tabela e bashkë-pagesave për shërbimet shëndetësore në nivel parësor) dhe Udhëzimin Administrativ për Certifikatat Shëndetësore Nr.04/2013 Sipas Shtojcës 1 ,, Çmimorja për certifikatat shëndetësore''.

Ministria e Shëndetësisë, mbetet në dispozicion të Komunës së Skenderajt dhe MAPL për çfarëdo sqarimi të mëtejmë në lidhje me këtë vlerësim.

Me respekt,

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada-Government

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm/Kancelarija Generalnog Sekretara/Office of Generaly Secretary

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO
MINISTRIA E MJEDISIT, PLANIFIKIMIT HAPËSINOR DHE INFRASTRUKTURËS
MINISTARSTVO ŽIVOTNE SREDINE, PROSTORNOG PLANIRANJA I INFRASTRUKTURE
MINISTRY OF ENVIRONMENT, SPATIAL PLANNING AND INFRASTRUCTURE
Njësia org. / Org.Jedinica / Org.Unit: SP-02
Nr. i Faqeve / Br. Stranica / No.Pages: -01-
Nr. i Prot. / Broj Prot. / Prot. No.: 2511-2/22
Data / Datum / Date: 08.06.22
PRISHTINË / A
No. 1

DATË/A:	03/06/2022
REFERENC-Ë:	
PËR/ZA/TO:	Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Ambientit Komuna Skenderaj
CC:	
NGA/OD/FROM:	Servet Spahiu, Zëvendësues i Sekretarit të Përgjithshëm i MMPHI-së
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Shqyrtimi i shkresës nga Komuna e Skenderajt me numër të protokollit 2511/22 të datës 29/04/2022 për dhënien e pëlqimit për Taksat e lejes ndërtimore

Të nderuar,

Bazuar në shkresën e datës 29/04/2022 me numër protokolli 2511/22, lidhur me caktimin e taksës administrative për leje ndërtimore dhe taksës administrative për leje rrënimi nga Komuna e Skenderajt (tutje si: Komuna), MMPHI ka shqyrtuar dhe analizuar shkresën se bashku me dokumentacionin përcjellës dhe konstaton si në vijim:

Komuna ka propozuar Taksat në pajtim me Ligjin Nr.04/L-110 për Ndërtim dhe Udhëzimin Administrativ Nr.02/2018 për taksat administrative për leje ndërtimore, leje rrënimi dhe tarifat për rregullimin e infrastrukturës.

Taksa Administrative për leje ndërtimore për kategorinë e I-rë e llogaritur nga Komuna është **1.30 €/m²** (një euro e tridhjetë centë për metër katror).

Taksa Administrative për leje ndërtimore për kategorinë e II-të e llogaritur nga Komuna është **3.41 €/m²** (tri euro e katërdhjetë e një cent për metër katror).

Taksa Administrative për leje rrënimi e llogaritur nga Komuna për kategorinë I dhe II është **0.50 €/m²** (zero euro e pesëdhjetë centë për metër katror).

Tarifa për rritjen e densitetit të infrastrukturës është llogaritur konform Shtojcës 7 të UA Nr.02/2018 dhe kjo Tarifë duhet të llogaritet vetëm për njësit e reja të banimit.

Komuna duhet të procedoj për aprovim taksat në pajtim me procedurat e parapara me Ligjin për Ndërtim Nr. 04/L-110.

Me respekt,

http://www.mmph-ks.org; E-mail: zsp.mmph@ks-gov.net

Jeton Osmani

From: Jeton Osmani
Sent: Wednesday, April 13, 2022 7:39 PM
To: Adelina Spahiu
Subject: Fwd: Rregullorja per taksa, tarifa, ngarkesa dhe gjoba, Komuna Skenderaj
Attachments: Rregullorja për Taksa me ndryshime të propozuara nga Ministria.doc

Merr Outlook për Android

From: Ardian Mehmeti <Ardian.Mehmeti@rks-gov.net>
Sent: Wednesday, April 13, 2022 2:49:40 PM
To: Jeton Osmani <Jeton.Osmani@rks-gov.net>
Cc: Lulzim Beqiri <Lulzim.Beqiri@rks-gov.net>; Ardian Bajraktari <Ardian.Bajraktari@rks-gov.net>; Floriana Rugova <Floriana.Rugova@rks-gov.net>
Subject: FW: Rregullorja per taksa, tarifa, ngarkesa dhe gjoba, Komuna Skenderaj

I nderuar z. Osmani,

Sa i përket emailit tuaj të poshtëshënuar, mund t'ju konfirmoj se Projekt Rregullorja në fjalë është në rregull për sa i përket rekomandimeve të MD-së dhe adresimeve të këtyre propozimeve/rekomandimeve nga ana juaj.

Andaj, mund të procedoni tutje sipas legjislacionit përkatës në fuqi.

Me respekt,

Ardian Mehmeti
Ministria e Drejtësisë

Sent from my Galaxy

From: Jeton Osmani
Sent: Wednesday, April 13, 2022 2:07 PM
To: Floriana Rugova <Floriana.Rugova@rks-gov.net>
Subject: Rregullorja per taksa, tarifa, ngarkesa dhe gjoba, Komuna Skenderaj

Pershendetje shpresoj qe jeni mire, po kaloni mire, po ua dergoj rregulloren e lartcekur, me ndryshimet e rekomanduar nga ana e juaj, ndryshimet jane harmonizuara me kerkesen qe na e keni derguar te dates 12.04.2022,